

SHËNDETËSIA NË KOSOVË: Emigrimi i mjekëve dhe punëtorëve shëndetësor

- Krahasuar me vendet e tjera të Evropës, Kosova ka numrin më të ulët të mjekëve për 100,000 banorë, një ndër shkallët më të ulëta të shpenzimeve për shëndetësi si përqindje e Bruto Produktit Vendor (BPV), si dhe numrin më të ulët të pacientëve të trajtuar.
- Për vitet 2019-2020, janë lëshuar 352 leje të punës për punëtorët shëndetësor nga Kosova në Gjermani.¹
- Nga viti 2018 deri në shtator të vitit 2022, Oda e Mjekëve të Kosovës ka lëshuar 666 certifikata të etikës dhe profesionit, dokument ky që kërkohet nga institucionet shëndetësore me rastin e punësimit të mjekëve dhe infermierëve jashtë Kosovës. Krahasuar me vitin 2020 kur kjo odë ka lëshuar 105 certifikata të tilla, nga Janari deri në Shtator 2022, e njejta ka lëshuar 183 certifikata.
- Gjatë vitit 2021 nga Oda e Infermierëve të Kosovës janë lëshuar 140 certifikata. Numri i certifikatave të lëshuara nga kjo odë, nga Janari deri në Shtator të vitit 2022, është katërfishuar në 586 certifikata.
- Shumë nga kapacitetet ekzistuese spitalore, qoftë teknike apo njerëzore, kanë mbetur të pashfrytëzuara për shkak të humbjes së besimit të pacientëve në sektorin publik.
- Kosovës i mungojnë të dhëna të sakta dhe një vlerësim gjithëpërfshirës i faktorëve kryesor të emigrimit, që do të identifikonte problemet dhe zgjidhjet adekuate.
- 59% e qytetarëve të Kosovës do të jetonin jashtë vendit, prej të cilëve 56% janë në faza të përpjekjeve për largim.²

Emigrimi i qytetarëve të Kosovës dhe fuqisë punëtore vazhdon të jetë një ndër sfidat kryesore për institucionet dhe shoqërinë, sidomos në sektorin e shëndetësisë. Pavarësisht kornizës ligjore dhe mekanizmave të ndërtuar për koordinimin dhe implementimin e politikave për migrim, mungojnë masa adekuate institucionale për të adresuar largimin e qytetarëve jashtë vendit.³ Mungesa e kushteve të punës në sektorin publik, pagat e ulëta dhe mospërputhja e kurrikulës arsimore me kërkesat e tregut të punës kanë sjellë si pasojë “largimin e trurit” (ang: “brain drain”), duke shkaktuar emigrim të një numri të madh të mjekëve dhe profesionistëve të tjerë shëndetësor. Kjo ndikon direkt në zhvillimin ekonomik të vendit dhe ngrit nevojën për aktivizim të menjëhershëm të institucioneve.

Mangësitë në sektorin publik të shëndetësisë kanë dëmtuar mirëqenien e qytetarëve në përgjithësi, duke sjellë si rezultat largimin e tyre në masë të madhe jashtë vendit, për kushte më të mira dhe qasje më të lehtë në shërbime shëndetësore.

Ndër faktorët kryesor të rritjes së emigrimit është papunësia e lartë dhe kushtet e përgjithshme ekonomike. Në pamundësi për të siguruar vende të punës për të gjithë ata që çdo vit arrijnë moshën e punës, emigrimi ka shërbyer njëkohësisht edhe si valvulë për të zvogëluar presionin në tregun e punës⁴.

Për më tepër, kërkesat e vendeve të zhvilluara për fuqi punëtore kanë rritur emigrimin e rregullt duke lehtësuar integrimin e mjekëve dhe punëtorëve shëndetësor emigrantë. Ky trend i migrimit kërkon rritjen e buxhetit për sektorin e shëndetësisë, për të siguruar paga më të larta dhe vende të reja të punës. Në mungesë të masave adekuate institucionale, situata mund të përkeqësohet pa një strategji efikase të menaxhimit.

1 Raporti i Institutit GAP, Si do të ndikojë pandemia Covid-19 dhe kufiri i ri i imigracionit të Gjermanisë në migrimin nga Kosova?, Prill 2021.

2 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Barometri për Ballkanin, Qershor 2022, në <https://bit.ly/3Ds00BL>

3 Raporti i Grupit për Ballkan, Kosova: Trendet e migrimit kërkojnë një qasje të re strategjike, Shtator 2020.

4 Banka Botërore, Republika e Kosovës - Diagnostifikimi sistematik i vendit. Janar 2017, në <https://bit.ly/3FDhzkR>


Për të siguruar menaxhim efikas të trendeve të migrimit dhe për të parandaluar largimin e fuqisë punëtore në sektorin e shëndetësisë, institucionet e Kosovës duhet të ndërmarrin hapa konkret, përfshirë:

- Të rritet buxheti për sektorin e shëndetësisë duke ju afruar mesatares së BE-së prej 9,9% të Bruto Produktit Vendor. Momentalisht, Kosova shpenzon 4.4% të BPV për sektorin e shëndetësisë. Një faktor që do t'i kontribuonte rritjes së financimit në sektorin e shëndetësisë është edhe zbatimi i Ligjit për sigurime shëndetësore.
- Me urgjencë të rriten pagat për punëtorët shëndetësor në harmoni me pagat e vendeve të tjera të rajonit dhe vendeve të tjera Evropiane (mjekët, infermierët etj).
- Të ofrohen bursa për specializim jashtë vendit, me kusht që përfituesit të kthehen për të shërbyer dhe punuar në sistemin shëndetësor publik të vendit për një periudhë të caktuar kohore.
- Të aplikohet punësimi i menjëhershëm i mjekëve të përgjithshëm pas përfundimit të studimeve me qëllim të asistojnë mjekët specialist, njëkohësisht edhe të fitojnë përvojë, çka do të kontribuonte në parandalimin e emigrimit.
- Specializantët të futen në sistemin e rregullt të pagave, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve. Kjo do të siguronte përfshirje më të madhe të specilizantëve në sistemin shëndetësor.
- Autoriteti Qeveritar për Migrim (AQM) duhet të avancojë të dhënat për profilin e migrimit. si dhe të përmirësohet bashkëpunimi ndërinstitucional që të rriten mundësitë për punëtorët shëndetësor dhe të parandalohet emigrimi.

POPULLSIA, FUQIA PUNËTORE DHE MIGRACIONI

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2011, Kosova ka 1.7 milion banorë.⁵ Regjistrimi i ardhshëm i popullsisë pritet të bëhet në pjesën e dytë të vitit 2023, por sipas vlerësimeve më të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në fund të vitit 2021 Kosova kishte 1.8 milion banorë.⁶ Parashikimet për dekadat e ardhshme tregojnë se në vitin 2061, Kosova pritet të ketë më pak se 1.5 milion banorë. Përveç rënies së popullsisë, parashihet që edhe moshë mesatare të rritet dhe popullsia e moshës mbi 65 vjeçare të jetë më e lartë sesa ajo e grupmoshave deri 14 vjeç. Po ashtu, parashihet rënie e popullsisë në moshë të punës.

Grafikoni nr.1: Vlerësimi i popullsisë sipas grupmoshave (vlerësimi i mesëm), 2011-2061



Burimi: BPRG, bazuar në të dhënat e ASK-së

Arsyet kryesore për këtë janë rënia e natalitetit dhe emigrimi. Sipas ASK-së, shkalla e përgjithshme e natalitetit do të bie nga 2.41 në nën 2 deri në vitin 2031⁷. Në anën tjetër, nga viti 2013 deri në vitin 2021 kanë emigruar afër 300 mijë kosovarë (këtu nuk janë llogaritur të kthyerit).⁸


5 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Popullsia e Kosovës 2021 – vlerësim, Qershor 2022, në <https://bit.ly/3foA3Lv>

6 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2017-2061, Dhjetor 2017, në <https://bit.ly/3fujyjh>

7 Ibid.

8 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Raportet për vlerësimin e popullsisë, 2013-2021, në <https://bit.ly/3fspC9I>


Grafikoni nr.2: Emigrimi ndërkombëtar 2013 – 2021



Burimi: BPRG, bazuar në të dhënat e ASK-së për vlerësimin e popullsisë

Preferenca për migrim e kosovarëve është më e larta në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP). Matjet e opinionit, të kryera nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC) për vitin 2022, tregojnë se 59% e kosovarëve do të jetonin dhe punonin jashtë vendit.⁹ Nga ata që kanë shprehur pëlqimin që të jetojnë dhe punojnë jashtë Kosovës, 56% vetëm se janë në faza të ndryshme të përpjekjeve për largim. Shumica preferojnë vendet e BE-së (67%), kurse pjesa tjetër ShBA-në (17%) dhe vendet tjera të BP (14%).

Grafikoni nr.3: Përqindja e qytetarëve të Kosovës që do të donin të jetonin jashtë Kosovës ndër vite



Burimi: BPRG, bazuar në Balkan Barometer 2022

Në dekadën e fundit kryesisht kanë emigruar të rinjtë e grupmoshave 25-44 vjeç, të cilët përbëjnë 44% të popullsisë emigruese. Kjo është mosha kryesore riprodhuese në aspektin e fertilitetit dhe fuqisë punëtore.¹⁰ Mbi gjysma e atyre që kanë marrë leje qëndrimi në vendet e BE-së janë bashkime familjare (51%), 26.4% për qëllim punësimi, 1.5% për qëllim të arsimimit, ndërsa leje qëndrime të klasifikuara për arsye të tjera përbëjnë 21% të të gjitha kategorive.¹¹

Në vitet 2014-2015 kishte një valë të madhe të emigrimit të parregullt, por nga viti 2016 vërehet një trend në rritje i emigrimit të rregullt.

Një ndër arsyet e rënies së emigrimit të parregullt dhe rritjes së emigrimit të rregullt ka të bëjë edhe me ndryshimin e politikave të BE-së dhe vendeve anëtare. Pas valës së emigrimit të parregullt të viteve 2014-2015, shumë shtete të BE-së ashpërsuan masat e azilit dhe përshpejtuan procedurat e kthimit të emigrantëve të parregullt.

⁹ Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, Barometri për Ballkanin, Qershor 2022, në <https://bit.ly/3Ds00BL>

¹⁰ Autoriteti Qeveritar për Migrim, Profili i zgjeruar i migrimit 2013-2017, Dhjetor 2018, në <https://bit.ly/3zEsgjk>


¹¹ Autoriteti Qeveritar për Migrim, Profili i lehtë i migrimit 2020, 2021, në <https://bit.ly/3U3Xbh8>

Në vitin 2015, Gjermania aprovoi Rregulloren për Ballkanin Perëndimor dhe në këtë formë hapi tregun e punës për fuqinë punëtore nga Ballkani. Kjo ndikoi në rritjen e emigrimit të rregullt edhe nga Kosova. Fillimisht kjo rregullore kohëzgjatjen e kishte deri në vitin 2020, por u vazhdua deri në vitin 2023. Në bazë të saj, është bërë më e lehtë që punëtorët e pakualifikuar të punësohen në Gjermani. Përderisa punëtorët e huaj pa ndonjë kualifikim në tregun gjerman në vitin 2012 përbënin 28%, në vitin 2018 kjo kategori e punëtorëve u rrit në 36%.¹²

Bazuar në Rregulloren për Ballkanin Perëndimor, përgjatë viteve 2016-2020, nga 320,489 kontrata të punës që u arritën mes punëdhënësve gjerman dhe punëkërkuësve nga BP, 28.2% ishin nga Kosova (92,655 kontrata pune të siguruara).¹³ Mirëpo, jo të gjithë ata që fituan kontrata pune arritën që të fillojnë punën. Arsye për këtë ishin gabimet në dokumentacion dhe sidomos mungesa e kapaciteteve në ambasadën gjermane për të pajisur me viza të gjithë ata që kishin kontrata valide të punës. Në fund, për të njëjtën periudhë u lëshuan 21,435 viza pune (22.4% e aplikantëve për viza pune).¹⁴

Emigrimi vazhdon trendin e njëjtë pavarësisht të dhënave zyrtare të ASK-së që tregojnë se viteve të fundit janë rritur vendet e punës dhe ka rënë papunësia dhe punësimi i paqëndrueshëm. Kosova është i vetmi vend në rajonin e BP që edhe më tej ka net rritje të fuqisë punëtore, përderisa të gjitha vendet tjera kanë rënie.¹⁵

Grafikoni nr.4: Të punësuarit dhe shkalla e papunësisë në Kosovë, 2012-2021



Burimi: BPRG, bazuar në të dhënat e ASK-së për tregun e punës, 2012 - 2021

Kjo ndodhë për faktin se Kosova ka përqindje të lartë të popullsisë të grupmohës 0-14 vjeç, por siç shihet në grafikonin 1, pas vitit 2030 parashihet rënie e madhe e fuqisë punëtore nëse vazhdojnë këto trende të emigrimit. Kjo tregon se mungesa e vendeve të punës nuk është arsyeja e vetme e emigrimit, por ekzistojnë faktorë të shumëfishtë. Kosovarët gjithnjë e më shumë janë të shqetësuar për gjendjen në arsim, shëndetësi dhe rritjen e shkallës së emigracionit.

Shumica e punonjësve kanë paga neto mes 400 dhe 500 euro në muaj. Paga mesatare neto në Kosovë është 432 euro, përderisa në sektorin publik dhe ndërmarrjet publike është më e lartë (611 euro neto), se sa në sektorin privat (376 euro neto).¹⁶

KËRKESA PËR PUNËTORË SHËNDETËSOR NË VENDET E EVROPËS

Brenda vendeve të BE ka lëvizje të mëdha të mjekëve. Përfituesit më të mëdhenj nga lëvizjet e punëtorëve shëndetësor janë vendet anëtare të Shoqatës Evropiane për Tregti të Lirë (EFTA), që përbëhet nga Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra. Si pasojë e plakjes së popullsisë dhe rritjes së jetëgjatësisë, të gjitha vendet tjera të BE-së janë në kërkim të punëtorëve shëndetësor.¹⁷ Sipas një raporti, gjysma e vendeve anëtare të BE kanë mungesë të

¹² Raporti i Institutit GAP, Emigrimi i fuqisë punëtore të Kosovës në Gjermani, Shkurt 2020.

¹³ Raporti i Institutit GAP, Si do të ndikojë pandemia Covid-19 dhe kufiri i ri i imigracionit të Gjermanisë në migrimin nga Kosova?, Prill 2021.

¹⁴ Ibid.

¹⁵ Aspen Institute, Emigrimi nga Ballkani Perëndimor, 2020, në <https://bit.ly/3T0yjqp>

¹⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Niveli i pagave në Kosovë 2021, në <https://bit.ly/3sUSRF3>

¹⁷ Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare, Kërkohen profesionistë shëndetësor: Lëvizja zingjirore nëpër vendet evropiane, Qershor 2020, në <https://bit.ly/3WtsVxR>

Tabela nr.1: Mungesa e punëtorëve shëndetësor në disa nga vendet e BE-së dhe Britani

	Belgikë	Danimarkë	Gjermani	Irlandë	Francë	Holandë	Finlandë	Britani	Estoni	Bullgari	Kroaci	Letoni	Lituani	Sloveni	Slovaki
Mjekët	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
Infermierët	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
Profesionistët tjerë shënd.	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■

Burimi: BPRG, bazuar në raportin e Institutit të Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare 2020

* Fushat e hijezuara tregojnë mungesën e punëtorëve shëndetësor

Deri në vitin 2030, në të gjitha vendet e BE, kërkesat për profesionistë shëndetësor do të rriten për dy arsye: për zëvendësimin e punëtorëve që dalin në pension dhe për zgjerimin e shërbimeve shëndetësore si pasojë e plakjes së popullsisë dhe rritjes së jetëgjatësisë.¹⁹

Mungesën e punëtorëve shëndetësorë vendet e BE po e kompensojnë duke punësuar punëtorë nga vendet tjera. Një në dhjetë mjek në vendet e BE në vitin 2017 ishte i/e lindur jashtë vendit. Në Irlandë, gjysma e mjekëve kanë lindur jashtë vendit; në Zvicër dhe Suedi, një në tre mjek kanë lindur jashtë vendit; në Austri 5%, Itali 1%, etj.²⁰

Dallimi në pagesa për punëtorët shëndetësor është një ndër faktorët kryesor të lëvizjes së mjekëve brenda vendeve të BE dhe emigrimit nga vendet e treta. Me rënien e kompensimeve për punëtorët shëndetësor, viteve të fundit në Britani të Madhe, 4% e punonjësve në këtë sektor u larguan nga vendi. Por, duke marrë parasysh se pagat në këtë sektor janë sërish më të larta se në vendet tjera, Britania ka arritur të kompensojë largimet duke pranuar punëtorë nga Italia, Greqia, Portugalia dhe vendet tjera të Evropës Jug-Lindore.²¹ Norvegjia dhe Suedia, për shkak të kompensimeve të larta për punëtorët shëndetësor, janë vende atraktive për punëtorët që përbëjnë vendet e BE15²². Zvicra, e cila paguan punëtorët shëndetësor dy herë më shumë se sa vendet që përbëjnë BE15-shin, është atraktive për punëtorët shëndetësor nga Gjermania, Franca, Italia dhe Austria; përderisa Norvegjia ka arritur të tërheqë punëtorët shëndetësorë nga Suedia, Danimarka, Spanja, Polonia, Lituania dhe Hungaria. Gjermania dhe vendet tjera të BE15 tërheqin punëtorë shëndetësor nga vendet tjera të Evropës Qendrore dhe Juglindore, veçanërisht nga vendet e Ballkanit Perëndimor.²³

Tabela nr.2: Të dhënat për punëtorët shëndetësor dhe shkalla e largimit nga pesë vendet e BP-së

	2010	2017
Shqipëria	7 %	18 %
Bosnja dhe H.	8 %	14 %
Serbia	4 %	8 %
Maqedonia e V.	17 %	22 %
Mali i Zi	0 %	3 %

Burimi: BPRG, bazuar në raportin e Institutit të Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare 2020

Hendeku për sa i përket të ardhurave mesatare në sektorin e shëndetësisë në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) dhe vendet e BE-së mbetet aq i lartë sa për të gjeneruar norma të larta të emigracionit të profesionistëve shëndetësorë. Në vitin 2018, pagat mesatare në sektorin e shëndetësisë dhe punëve sociale në vendet e BP ishin dy deri tri herë më të ulëta se mesatarja e pagave në të njejtin sektor në vendet e BE. Punëtorët shëndetësor në Shqipëri dhe Serbi paguhën afër tri herë më pak se sa ata në Gjermani. Bosnja ka përjetuar largimin më të madh të punëtorëve shëndetësor në krahasim me vendet tjera të Ballkanit dhe viteve të fundit ka rritur pagat dukshëm në këtë sektor, por sërish ato mbeten sa gjysma e pagave në Gjermani.²⁴

18 Ibid.

19 Ibid.

20 Ibid.

21 Ibid.

22 Austria, Belgjika, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Portugalia, Spanja, Suedia, Britania.


23 Institut i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare, Kërkohen profesionistë shëndetësor: Lëvizja zingjirore nëpër vendet evropiane, Qershor 2020, në <https://bit.ly/3WtsVxR>

24 Ibid.

GJENDJA E SEKTORIT TË SHËNDETËSISË NË KOSOVË

Të dhënat e ASK-së tregojnë se në Kosovë, në vitin 2021 janë 34,468 punëtorë shëndetësorë, të anëtarësuar në pesë odat kryesore të punonjësve shëndetësor.²⁵ Ligji për Odat e Profesionistëve Shëndetësor ka formuar pesë oda dhe anëtarësia në to është e detyrueshme.²⁶

Grafikoni nr.5: Anëtarësia në odat e punonjësve shëndetësor, 2018-2021



Burimi: BPRG, bazuar në raportet e ASK-së për shëndetësinë, 2018-2021

Të punësuar në institucionet publike të shëndetit në vitin 2021 janë 13,448 punonjës. Numri i punonjësve në sektorin publik ka shkuar duke rënë nga viti 2017.


Grafikoni nr.6: Të punësuar në institucione publike



Burimi: BPRG, bazuar në të dhënat e ASK-së për shëndetësinë, 2012-2021

Në anën tjetër, numri i mjekëve dhe infermierëve në spitale private ka shkuar duke u rritur.

Grafikoni nr.7: Numri i spitaleve private, mjekëve dhe infermierëve




Burimi: BPRG, bazuar në të dhënat e ASK-së për shëndetësinë, 2015-2021

25 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e shëndetësisë 2018-2021, në <https://bit.ly/3DZ9kP2>

26 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr.04/L-150 për odat e profesionistëve shëndetësor, 2013, në <https://bit.ly/3SXx9el>

Po ashtu është rritur edhe numri i përgjithshëm i institucioneve private shëndetësore të licensuara, thuajse duke u dyfishuar në dekadën e fundit.


Grafikoni nr.8: Institucione private shëndetësore të licensuara në Kosovë për vitet, 2012-2021



Burimi: BPRG, bazuar në të dhënat e ASK-së për shëndetësinë, 2012-2021

Sipas të dhënave të Odës së Mjekëve të Kosovës, 28% e mjekëve janë të moshës 24 deri 34 vjeç; 19% i takojnë grupmoshës 35-44 vjeç; 19% të grupmoshës 45-54 vjeç; 26% të grupmoshës 55-64 vjeç; 8% mbi moshën 65 vjeç.

Grafikoni nr.9: Punëtorë shëndetësor për 100,000 banorë



Në fillim të tetorit 2022 u raportua përmes një studimi se në sektorin publik të shëndetësisë janë të punësuar 200 mjekë dhe 1,500 infermierë tepër.²⁷ Por, të dhënat e Eurostat e nxjerrin Kosovën të fundit në Evropë për sa i përket numrit të mjekëve specialistë, me 170 mjekë për 100 mijë banorë (sipas të dhënave të 2018), për dallim prej mesatares së BE-së prej 388 mjekë për 100 mijë banorë dhe vendeve të rajonit prej mbi 200 mjekë specialist për 100 mijë banorë.

Sipas një raporti të vitit 2019, kapacitetet spitalore ekzistuese në sektorin publik në Kosovë janë të nënshfrytëzuara, pacientët nuk i besojnë sektorit publik, mungojnë pajisjet, ka probleme në menaxhim dhe të gjitha qendrat rajonale ofrojnë të njëjtat shërbime, në vend se të specializohen në disa shërbime. Kjo bën që kapacitetet ekzistuese të mjekëve dhe infermierëve të mos shfrytëzohen në kapacitet të plotë.²⁸

Edhe pse spitalet e Kosovës kanë 2.2 shtretër për 1,000 banorë, shifër shumë më e ulët se sa mesatarja e vendeve të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) prej 5.3 shtretërve për 1,000 banorë, vetëm 50% e shtretërve në spitale shfrytëzohen, shifër shumë më e ulët se standardi optimal prej 85% të shfrytëzimit


27 Koha.net, KTV, Studimi i ekspertit gjerman për shëndetësinë në Kosovë, 200 mjekë e 1500 infermierë tepër, 4 tetor 2022, në <https://bit.ly/3DZxOaB>

28 Banka Evropiane për Investime, Asistencë Teknike, Përmirësimi i Infrastrukturës Fizike të Institucioneve Shëndetësore Dytësore dhe Terciare, Studim i fizibilitetit, 17 prill 2019

që duhet të synohet. Janë së paku 24 reparte në spitalet regjionale dhe shërbimin terciar që trajtojnë më pak se 1,000 pacientë, numri minimal për trajtim dhe menaxhim eficient.²⁹ Kjo ndodhë për faktin se shumë pacientë nga Kosova kërkojnë shërbime jashtë vendit ose në spitalet private brenda vendit. Vetëm brenda nëntë muajve të vitit 2018, 1,102 pacientë kanë kërkuar trajtim jashtë vendit me mbështetje të institucioneve publike.³⁰

Në krahasim me vendet e rajonit dhe me mesataren e BE-së, Kosova shpenzon më së paku për shëndetësi si përqindje të Bruto Produktit Vendor (BPV), me përjashtim Shqipërinë e cila shpenzon më pak. Përderisa Kosova shpenzon 4.4% në shërbimet shëndetësore, mesatarja në vendet e BE-së është 9.9%.


Grafikoni nr.10: Shpenzimet për shëndetësi, si % e BPV



Burimi: Eurostat

Duke përjashtuar Shqipërinë, Kosova ka edhe numrin më të vogël të shërbimeve ndaj pacientëve për 100,000 banorë në krahasim me vendet tjera të rajonit dhe mesataren e BE-së.

Grafikoni nr.11: Shërbime (pacientë) për 100.000 banorë



Burimi: Eurostat

29 Ibid.

30 Ibid.

Kosova ka numër të vogël të mjekëve për kokë banori dhe një pjesë e buxhetit të shtetit shpenzohet për përgatitjen e mjekëve specialistë dhe për subvencionimin e specializantëve. Megjithatë, për shumë vite me radhë, një numër i madh i mjekëve specialistë dhe specializantëve nuk arrijnë të punësohen në institucionet publike. Në njëërën nga seancat plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur në vitin 2016, ministri i shëndetësisë kishte deklaruar se, në disa raste, specialistët presin për punë deri në tetë vite.³¹ Në atë kohë, Kuvendi ndajti €325,000 për rreth 100 mjek specialistë të papunë, si zgjidhje e përkohshme. Në anën tjetër, 764 specializantë ishin të papunë ose në proces të specializimit.³²

Sipas vendimit të Kuvendit të vitit 2016, institucionet publike duhet të punësojnë rreth 1000 mjekë specialistë dhe specializantë, por ky vendim nuk u zbatua asnjëherë. Të dhënat tregojnë se numri i të punësuarve në institucionet publike shëndetësore mes viteve 2016 dhe 2021 ka rënë për rreth 1000. Specialistët dhe specializantët kanë protestuar në vazhdimësi duke kërkuar angazhimin e tyre në institucione publike (shih grafikonin nr. 8).

Në fillim të muajit tetor 2022, Ministria e Shëndetësisë u bëri thirrje publike të gjithë mjekëve të përgjithshëm dhe specialistëve të papunë që të paraqiten pranë Ministrisë së Shëndetësisë mes datave 6 dhe 8 tetor.³³ Kësaj thirrje do të duhej t'i përgjigjeshin gjithsej 395 mjekë të papunë, por, sipas Odës së Mjekëve dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë, prej tyre janë lajmëruar vetëm 100 mjekë.³⁴ Kjo tregon se shumica e mjekëve që nuk janë të punësuar në Kosovë mund të jenë në proces punësimi jashtë vendit, për shkak të disa faktorëve, përfshirë nivelin e ulët të pagave.³⁵


EMIGRIMI I PUNËTORËVE SHËNDETËSOR NGA KOSOVA

Aktualisht largimi i punëtorëve shëndetësor nga Kosova është një problem i vazhdueshëm. Edhe punëtorët shëndetësor nga Kosova emigrojnë për të njëjtat arsye që emigrojnë punëtorët shëndetësorë nga vendet tjera: për shkak të pagave të ulëta dhe për shkak të kërkesës së lartë për këtë profesion në vendet më të zhvilluara. Sipas të dhënave të Odës së Mjekëve të Kosovës, arsyet që më së shpeshti përmenden nga mjekët që largohen nga Kosova kanë të bëjnë me mungesën e vendeve të punës (38% e të anketuarve), pagat e ulëta (31%), kushtet e punës (27%), arsye të tjera (4%).

Sipas një studimi, 14.43% e punëtorëve shëndetësor të anketuar kanë deklaruar se dëshirojnë të emigrojnë, prej tyre, 20.81% e mjekëve të Kosovës kanë deklaruar se dëshirojnë të emigrojnë, 12.81% e infermierëve dhe 13.59% punëtorëve tjerë shëndetësor.³⁶ Pandemia Covid-19 vetëm se ka rritur gatishmërinë për emigrim.

Secili punëtor shëndetësor që emigron për arsye të punës duhet të marrë një çertifikatë mbi të kaluarën etike dhe profesionale, të cilën e lëshojnë odat e profesionistëve shëndetësor. Sipas të dhënave të Odës së Mjekëve, nga viti 2018 deri në shtator të 2022 kjo odë ka lëshuar 666 çertifikata të tilla. Njësoj, sipas të dhënave të Odës së Infermierëve të Kosovës, dy vitet e fundit janë lëshuar 726 çertifikata.

Grafikoni nr.12: Çertifikata të etikës dhe profesionit të lëshuara nga odat



Burimi: Oda e Mjekëve të Kosovës dhe Oda e Infermierëve të Kosovës

31 Kuvendi i Kosovës, Seanca plenare, 14 korrik 2016, në <https://bit.ly/3gMqAy9>

32 Deklarimi i ministrit të shëndetësisë Imet Rrahmani në seancën plenare të 14 korrik 2016, në <https://bit.ly/3gMqAy9>

33 Njoftim i Ministrisë së Shëndetësisë, në <https://bit.ly/3AWILZK>

34 Oda e Mjekëve të Kosovës, punëtorja e organizuar nga Grupi për Ballkan, Prishtinë, 28 tetor 2022.


35 Po aty

36 Nora Murataj dhe të tjerët, Qëllimi i migrimit të punëtorëve të kujdesit shëndetësor gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë, 5 shtator 2022, në <https://bit.ly/3EalTXX>

Nuk ka të dhëna të sakta se sa punëtorë shëndetësor janë larguar nga vendi. Bazuar në të dhënat e Agjencisë Federale të Punësimit të Gjermanisë për vitet 2019-2020, janë lëshuar 352 leje të punës për punëtorët shëndetësor nga Kosova nga punëdhënësit e sektorit të shëndetësisë dhe shërbimeve sociale në Gjermani, duke shfrytëzuar Rregulloren për Ballkanin Perëndimor.³⁷

Në përgjithësi, në mars të vitit 2019 ishin 7,204 kosovarë të punësuar në shërbimet shëndetësore në Gjermani.³⁸

Grafikoni nr.13: Punëtorët shëndetësor nga BP në Gjermani



Burimi: Deutsche Welle

Krahas Rregullores për Ballkanin Perëndimor, punëtorët shëndetësor, si kategori e punëtorëve të kualifikuar, mund të emigrojnë shumë lehtë në Gjermani në bazë të Ligjit Gjerman për Migrimin e Fuqisë së Kualifikuar Punëtorë, i cili ka hyrë në fuqi nga marsi i vitit 2020.³⁹ Në nivel të BE-së, me qëllim të thjeshtëzimit dhe përsheptimit të procedurave për leje të punës për ato kategori deficitare, ekziston mundësia e pajisjes me Kartonin e Kaltër, i cili ua mundëson edhe mjekëve specialist që të punësohen në secilin vend të BE-së, duke tërhequr edhe anëtarët e familjes.⁴⁰

Në korrik të vitit 2019, ministri i Shëndetësisë së Kosovës dhe ministri i Shëndetësisë së Gjermanisë nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi qëllimi i së cilës ishte edhe lehtësimi i punësimit për infermierët nga Kosova në Gjermani. Në konferencë për media me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes, ministri i Shëndetësisë së Gjermanisë deklaroi se Gjermania ka nevojë për rreth 70 mijë infermierë dhe këtë numër të madh të infermierëve mund ta sigurojnë vetëm me ardhjet nga vendet tjera, dhe Kosova është shteti i parë me të cilën u nënshkrua marrëveshja e kësaj natyre.⁴¹

Më vonë një marrëveshje e tillë do të nënshkruhej edhe mes Bosnjës dhe Gjermanisë. Për dallim nga marrëveshjet e tilla të nënshkruara në kohën e ish-Jugosllavisë, marrëveshjet e reja nuk përfshijnë asnjë klauzolë për kthimin e punëtorëve pas punës së tyre të përkohshme në Gjermani.⁴²

Nënshkrimi i marrëveshjes mes Gjermanisë dhe Kosovës besohet se ka shtyrë shumë institucione private të arsimit të lartë që të hapin degë të studimeve për infermieri. Përderisa për çdo vit diplomojnë mesatarisht 350 studentë të infermierisë nga institucionet publike, në të njëjtën kohë diplomojnë rreth 4,000 nga institucionet private.⁴³

Për më tepër, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim lirim nga obligimi për pajisje me leje pune afatshkurtër për profesionistët shëndetësorë nga mërgata, të cilët me kërkesë të institucioneve shëndetësore të Kosovës, angazhohen përkohësisht në këto institucione. Pas licencimit nga Ministria e Shëndetësisë, këta profesionistë shëndetësorë mund të angazhohen në institucionet shëndetësore të Kosovës për një periudhë deri në 90 ditë brenda çdo periudhe prej 180 ditëve në një vit. Sipas këtij vendimi, për angazhime më të gjata duhet të fillojnë procedurën

37 Raporti i Institutit GAP, Si do të ndikojë pandemia Covid-19 dhe kufiri i ri i imigracionit të Gjermanisë në migrimin nga Kosova?, Prill 2021, në <https://bit.ly/3h8If2C>

38 Deutsche Welle, Rekrutimi i kujdestarëve ballkanik i ngjashëm me 'trafikimin e qenieve njerëzore', 14 janar 2020, në <https://bit.ly/3E0dPIY>

39 Marjan Icoski, Drejt një paradigme të re të ikjes së trurit të të rinjve në Ballkanin Perëndimor, German Marshall Fund, Gusht 2022, në <https://bit.ly/3E1omDW>

40 Bashkimi Evropian, Blue Card, në: <https://bit.ly/3zFuoHC>

41 Koha.net. Zyrtarizohet marrëveshja që çon më shumë infermierë kosovarë në Gjermani. 15 korrik 2019, në <https://bit.ly/2mmB4aS>

42 Marjan Icoski, Drejt një paradigme të re të ikjes së trurit të të rinjve në Ballkanin Perëndimor, German Marshall Fund, Gusht 2022, në <https://bit.ly/3E1omDW>

43 Radio Evropa e Lirë, Largimi i mjekëve e sakaton shëndetësinë kosovare, 12 gusht 2021, në: <https://bit.ly/3T4Q5HW>

e pajisjes me leje qëndrimi sipas legjislacionit në fuqi për të huajt. Po ashtu, në shtator u miratua edhe Udhëzimi Administrativ për licencimin e profesionistëve shëndetësorë të huaj. Me këtë Udhëzim Administrativ rregullohet procedura dhe kushtet e marrjes së licencës të profesionistit shëndetësor të huaj për ofrimin e kujdesit shëndetësor. Ky udhëzim lehtëson angazhimin e profesionistëve të huaj shëndetësor në ofrimin e shërbimeve në sistemin tonë shëndetësor.

Megjithatë, këto masa nuk janë të mjaftueshme. Largimi i mjekëve dhe profesionistëve të tjerë shëndetësor ka filluar që të japë efekte negative që tani, por efektet më shqetësuese pritet që të shihen në pesë vitet e ardhshme.⁴⁴ Në mungesë të mjekëve, shumica e qendrave mjekësore nëpër fshatra qëndrojnë të mbyllura. Migrimi i brendshëm i punëtorëve shëndetësor është dukuri e hershme në Kosovë, ku ka trend të largimit nga fshatrat dhe qytetet më të vogla në drejtim të qendrave kryesore.

Duke parë trendin e plakjes së popullsisë, në të ardhmen pritet që të rritet edhe numri i pacientëve të moshuar që kërkojnë trajtim në spitalet publike. Deri në vitin 2040 parashihet që popullsia e moshës mbi 65 vjeçare të rritet për 238%. Përderisa kërkesa për shërbime mjekësore për të rinjtë do të bie, rrjedhimisht do të ketë më pak kërkesë për shërbime të pediatriisë dhe shërbime tjera që ndërlidhen me gjeneratat e reja, por më shumë kërkesë për shërbime në neurologji, ortopedi, etj.

PROBLEMI ME TË DHËNAT E MIGRIMIT

Duke parë rritjen e migrimit nga vendet jashtë BE-së, në vitin 2005, Komisioni Evropian kërkoi nga vendet kandidate që të hartojnë një profil të përvitshëm të migrimit me qëllim të mbledhjes së të dhënave që kanë të bëjnë me situatën e tregut të punës, shkallën e papunësisë, kërkesën dhe ofertën e tregut të punës, nevojat profesionale në vend, lëvizjet migruese, lëvizjet hyrëse dhe dalje financiare të ndërlidhura me migrimin, përfshirë remitancat.⁴⁵ Për këtë qëllim, në nëntor të vitit 2013, Qeveria e Kosovës themeloi Autoritetin Qeveritar për Migrim (AQM), i cili funksion si mekanizëm ndërinstitucional që përfshinë të gjithë akterët relevant në fushën e migrimit dhe është përgjegjës për monitorimin e lëvizjeve migruese. AQM publikon një raport të rregullt vjetor të quajtur “Profili i Lehtë i Migrimit” i cili përmban të dhëna sa i përket trendeve më të fundit të migrimit.

Por, as Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) e as AQM nuk publikojnë të dhëna sa i përket profilit të atyre që emigrojnë. Edhe pse Ministria e Shëndetësisë është njëra ndër institucionet që e përbëjnë AQM-në, nuk ofron të dhëna të rregullta sa i përket emigrimit të punëtorëve shëndetësor. Këto të dhëna janë lehtë të posedueshme për faktin se odat mbajnë të dhëna për numrin e çertifikatave të lëshuara për ata punëtorë shëndetësor të cilët kërkojnë punë jashtë vendit dhe këto të dhëna raportohen çdo tre muaj në Ministrinë e Shëndetësisë.

Në anën tjetër, kapacitet e ASK-së në njësinë që merret me statistikën e migrimit janë të mangëta, kurse në përgjithësi ASK-ja ka nevojë edhe për 60 punonjës shtesë me qëllim të kryerjes së detyrave të saj.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Rritja e emigrimit të mjekëve dhe profesionistëve të tjerë shëndetësor kërkon vëmendjen dhe aktivizimin e menjëhershëm të institucioneve. Për shumë vite, remitancat nga diaspora kanë qenë një ndër shtytësit më të mëdhenjë të zhvillimit ekonomik në Kosovë dhe financues kryesor i konsumit. Përveç tyre, vizitat e rregullta vjetore të emigrantëve i sjellin Kosovës rreth miliona euro në vit. Por, largimi në masë të madhe i qytetarëve jashtë vendit viteve të fundit, sidomos i fuqisë punëtore, ka filluar të ketë pasoja të dukshme ekonomike dhe shoqërore.

Emigrimi i profesionistëve shëndetësor do të ketë edhe më shumë pasoja nëse institucionet e Kosovës nuk ndërmarrin masa adekuate. Për shkak të kërkesës së lartë për punëtorët shëndetësor në vendet e BE-së dhe pagave shumëfish më të larta, trendi i emigrimit pritet të rritet akoma në vitet e ardhshme. Qeveria duhet të zhvillojë politika gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në analiza të hollësishme për faktorët që po shtojnë emigrimin e mjekëve dhe punëtorëve të tjerë shëndetësor. Në të njëjtën kohë, institucionet duhet të bëjnë një vlerësim real të nevojave të tyre dhe krijimin e kushteve që këta profesionistë të vazhdojnë punën në vend.

⁴⁴ Ibid.

⁴⁵ Autoriteti Qeveritar për Migrim, Profili i zgjeruar i migrimit 2013-2017, Dhjetor 201, në <https://bit.ly/3zEsgjk>

Pagat e ulëta dhe kushtet jo të kënaqshme të punës kërkojnë një përqendrim të veçantë institucional. Këto janë ndër faktorët kryesor të emigrimit të punëtorëve në sektorin e shëndetësisë dhe si të tilla, kërkojnë ndërhyrje të shpejtë në politika dhe strategji. Mungesa e kushteve të nevojshme të punës dhe kapaciteteve të mjaftueshme teknike kërkon rritjen e financimit të përgjithshëm në këtë sektor. Institucionet duhet të rrisin shpenzimet për shëndetësi për të arritur mesataren e BE-së dhe kjo rritje në buxhet duhet të shoqërohet me rritjen e pagave për punëtorët shëndetësor.

Qeveria duhet të sigurojë vende të punës për ata që përfundojnë studimet, qoftë në vend apo jashtë vendit, për të parandaluar kështu demotivimin e tyre dhe largimin jashtë vendit. Gjendja aktuale në arsim, po ashtu ngrit kërkesat për përmirësim të standardeve dhe kurrikulave, duke i përshtatur të njëjtat me kërkesat e tregut të punës.

Masat e ndërmarra deri më tani nga institucionet nuk mjaftojnë për menaxhimin e trendit të rritjes së emigrimit. Gjendja aktuale mund të përkeqësohet brenda një periudhe të shkurtër, duke e lënë vendin me një mungesë të madhe të kapaciteteve njerëzore në shëndetësi. Humbja e profesionistëve të kualifikuar nga një sektor kyç për zhvillimin e vendit, siç është shëndetësia, do të prodhojë pasojë të dëmshme për ekonominë e vendit dhe kualitetin e jetës së qytetarëve. Prandaj, institucionet duhet të fokusohen aktivisht në ndërtimin e politikave dhe të mekanizmave adekuat për implementimin e tyre.

Për të siguruar menaxhim efikas të trendeve të migrimit dhe për të parandaluar largimin e fuqisë punëtore në sektorin e shëndetësisë, institucionet e Kosovës duhet të ndërmarrin hapa konkret, përfshirë:

- Të rritet buxheti publik për shëndetësi si përqindje e BPV duke ju ofruar mesatares së BE-së prej 9,9%. Rritja e buxhetit të shëndetësisë duhet të rezultojë me krijimin e kushteve më të mira të punës në institucionet publike shëndetësore. Zbatimi i Ligjit për sigurimet shëndetësore është një mundësi për rritjen e financimit në sektorin e shëndetësisë;
- Të rriten pagat për punëtorët shëndetësor me qëllim që të jenë të përafërta me vendet e rajonit dhe të konkurrueshme me vendet tjera evropiane. Ligji i pagave shihet si një zgjidhje afatshkurtër, por edhe me koeficientët e rinj që parashihen me versionin aktual të Ligjit të pagave, niveli i pagave do të mbetet më shumë se 100% më i ulët se sa në vendet e BE-së;
- Të ofrohen bursa për specializim jashtë vendit, me kushtëzim që pas periudhës së specializimit mjekët të kthehen dhe të punojnë për një periudhë disa vjeçare në institucionet publike.
- Punësimi i menjëhershëm i mjekëve të përgjithshëm pas përfundimit të studimeve me qëllim që të asistojnë për mjekët specialist, kështu duke fituar përvojë dhe duke ndaluar emigrimin. Kjo është e rëndësishme duke qenë se numri më i madh i atyre që emigrojnë janë pikërisht ata që diplomojnë dhe nuk mund të gjejnë një vend pune menjëherë pas diplomimit;
- AQM-ja duhet të avancojë të dhënat për profilin e migrimit, duke përfshirë të dhëna të detajuara për profesionistët e të gjitha fushave që emigrojnë jashtë vendit.

Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG) është një organizatë e pavarur rajonale, me qendër në Prishtinë, Kosovë. Ne ofrojmë analiza dhe rekomandime të politikave zhvillimore për një sërë çështjesh të ndërlydhura me shtet-ndërtim; konsolidim institucional e demokratik; integrimin e minoriteteve, dhe marrëdhënieve ndërshtetërore; si dhe integrimin Evropian dhe reformave politike. Ne kemi përvojë në hartimin, raportimin dhe zhvillimin e politikave, qasje strategjike dhe avokim me qeverinë, institucione ndërkombëtare dhe organizata jo-qeveritare.

Në thelbin e punës sonë qëndrojnë raportet tona rigoroze, të detajuar dhe të paanshme, të bazuara gjithmonë në hulumtimet në terren. Ne shkojmë përtej qëndrimeve kryesore dhe kërkojmë të bëjmë ndryshime përmes rekomandimeve për politika të cilat janë krijuese, të realizueshme dhe të matshme, për të ndihmuar në zhvillimin e demokracive të forta dhe shoqërive të bazuara në sundimin e ligjit në Ballkanin Perëndimor.

Ne angazhohemi në avokim të nivelit të lartë, si në rajon ashtu edhe ndërkombëtarisht, duke ndikuar njëkohësisht në diskutime mbi politikat, punët e brendshme dhe politika evropiane për Ballkanin Perëndimor.

Për të arritur këtë, Grupi për Ballkan ka dizajnuar instrumente dhe platforma të reja:

Dialogu Politik promovon dialogun e brendshëm të Kosovës, dhe agjendën e krijimit të reformave.

Forumi i Politikave (një Forum i Avokimit të Nivelit të Lartë) u angazhua për të përmirësuar dialogun midis shoqërisë civile dhe institucioneve.

Grupi për Avokim dhe Politika Kosovë-Serbi (një Forum për bashkëpunimin ndërkufitar të shoqërisë civile) synon të komunikojë, promovojë dhe forcojë dialogun drejt normalizimit të plotë midis Kosovës dhe Serbisë, dhe shoqërive të tyre.

Gratë në politikë promovon fuqizimin e grave dhe vajzave; sigurinë dhe gjithë-përfshirjen e tyre; dhe angazohet të forcoj ndikimin e Grupit të Grave në tërë Kosovën.

Platforma për Dialogun promovon procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke informuar publikun më të gjerë dhe duke nxitur debat për marrëveshjet, përfitimet dhe sfidat e Dialogut.

Komponenti i Mbështetjes nga Eksportët siguron mbështetje për qeverinë dhe institucionet kryesore në fushat e politikave, paqes dhe agjendat e shtet-ndërtimit.



Norwegian Embassy